



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

Nr. 74711 prot.

Tiranë, më 14. 5.2019

UDHËZIM

Nr. 5, datë 14. 5.2019

PËR

PROCEDURAT QË NDIQEN PËR PEZULLIMIN E USHTARAKUT NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenit 13, pika 2, germa "f", të ligjit nr. 64/2014 "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 24, të ligjit nr. 59/2014 "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe VKM-së nr. 854, datë 17.12.2004 "Për kriteret dhe masën e përfitimit të pagesës së papunësisë për bashkëshortin/en e ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura",

U D H Ë Z O J:

**KREU I
TË PËRGJITHSHME**

1. Hyrje.

Në kuadrin e përmirësimit të sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore është bërë i nevojshëm edhe përcaktimi i procedurave dhe kriterëve që ndiqen për pezullimin e ushtarakut aktiv nga detyra, të cilat do të qartësonin strukturat përgjegjëse në lidhje me mënyrën e veprimit dhe përgjegjësinë e secilës strukturë në kuadër të pezullimit administrativ.

2. Qëllimi.

Ky udhëzim rregullon procedurat për pezullimin nga detyra të ushtarakëve të të gjitha kategorive gjatë shërbimit aktiv në Forcat e Armatosura.

3. Fusha e zbatimit.

Kërkesat dhe procedurat e përcaktuara në këtë udhëzim përdoren në rastet e pezullimit të ushtarakëve nga detyra, me përjashtim të pezullimit disiplinor, i cili rregullohet me ligj të veçantë. Zbatimi i tyre është i detyrueshëm për të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura.

4. Strukturat dhe përgjegjësitë e tyre.

- a) Strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij udhëzimi janë:
- Shtabi i Përgjithshëm i FA-së;
 - Komandat e Forcave/strukturat mbështetëse dhe strukturat në vartësi të MM-së dhe SHPFA-së;
 - Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në MM;
 - Drejtoria e Personelit në SHPFA;
 - Atashetë Ushtarakë;
- b) Përgjegjësitë e strukturave përgjegjëse janë:
- të përcaktojnë shkaqet e pezullimit të ushtarakut;
 - të zbatojnë procedurat sipas afateve dhe kompetencave për pezullim nga detyra;
 - të bëjnë pezullimin nga detyra të ushtarakut me urdhër sipas kompetencave: Për oficerët ministri i Mbrojtjes me propozim të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së; Për ushtarët dhe nënoficerët e Forcës/strukturës mbështetëse komandanti i Forcës/strukturës mbështetëse; Për ushtarët dhe nënoficerët e SHPFA-së, MM-së dhe strukturave të varësisë të SHPFA-së dhe MM-së shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, me propozim të strukturës përkatëse;
 - atashetë ushtarakë të ndjekin dhe të mbajnë kontakte të vazhdueshme me ushtarakët që ndjekin studimet dhe drejtoritë në MM, SHPFA dhe Komandat e Forcave/strukturat mbështetëse;
 - AISM dhe/ose PU kur marrin dijeni për procedimin penal të ushtarakut, të ndjekin në vazhdimësi procesin dhe në rast sigurimi të vendimit të formës së prerë të gjykatës ta dërgojnë në strukturën përkatëse;
 - Komandat e Forcave/strukturat mbështetëse janë të detyruara të ndjekin procedimin penal dhe të sigurojnë në kohën e duhur vendimin e formës së prerë të gjykatës;
 - strukturat përgjegjëse gjatë periudhës së pezullimit nga detyra të ushtarakut të bëjnë ose jo trajtimin financiar sipas akteve ligjore, nënligjore dhe sipas këtij udhëzimi.
 - strukturat përgjegjëse, në përfundim të pezullimit nga detyra, të ndjekin procedurat për rikthim në detyrë ose për daljen në lirim të ushtarakut, për rastet e parashikuara në Kreun II, pikën 2, germet “a”, “b” dhe “c”.

5. Referencat ligjore.

- ligji nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- ligji nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- VKM nr. 854, datë 17.12.2004 “Për kriteret dhe masën e përfitimit të pagesës së papunësisë për bashkëshortin/en e ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura”;
- udhëzimi nr. 353, datë 31.05.2005 “Për zbatimin e kriterëve të VKM nr. 854, datë 17.12.2004.

KREU II PEZULLIMI

1. Kuptimi i pezullimit.

Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënieve të punës për aq kohë sa zgjat arsyeja e ndërprerjes. Në mbarim të kësaj periudhe, ushtaraku emërohet në detyrë në përputhje me gradën që mban, me përjashtim të rastit kur dënohet me burgim me vendim të gjykatës të formës së prerë.

2. Shkaqet e pezullimit.

Ushtaraku pezullohet:

- a) kur ndaj tij fillon ndjekja penale dhe vendoset masa e sigurisë arrest me burg ose arrest në shtëpi, deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë nga gjykata;
- b) kur ndaj tij fillon procedimi penal për vepra penale që lidhen me detyrën;
- c) kur me nismën e vet ushtaraku ndërmerr periudha studimi mbi 6 muaj dhe në lidhje me profesionin që ai ushtron;
- ç) për të shoqëruar bashkëshortin/en, që emërohet jashtë shtetit në funksione zyrtare.

3. Kompetencat për pezullimin nga detyra.

- a) pezullimi nga detyra i oficerëve bëhet me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, me propozim të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së;
- b) pezullimi nga detyra i ushtarëve dhe nënoficerëve të Forcës/strukturës mbështetëse bëhet me urdhër të komandantit të Forcës/strukturës mbështetëse;
- c) pezullimi i ushtarëve dhe nënoficerëve të SHPFA-së, MM-së dhe strukturave të varësisë të SHPFA-së dhe MM-së bëhet me urdhër të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, me propozim të komandantit të strukturës përkatëse.

4. Konstatimi i pezullimit.

Pezullimi konstatohet nga strukturat përgjegjëse për menaxhimin e personelit në Komandën e Forcave, strukturat mbështetëse, SHPFA dhe MM, me marrjen dijeni të njërit prej shkaqeve të pezullimit të përcaktuar në pikën 2, germat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të Kreut II të këtij udhëzimi.

5. Procedurat që ndiqen për pezullimin e ushtarakut nga detyra.

5.1. Procedurat që ndiqen kur pezullimi i referohet shkakut të përcaktuar në germat “a” dhe “b”, të pikës 2.

- a) Konstatimi i pezullimit në këtë rast bëhet nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore mbi bazën e njoftimit të Policisë Ushtarake ose me iniciativën e vet, për masën e sigurisë të vendosur ndaj ushtarakut/es arrest me burg ose arrest shtëpie ose për fillimin e

procedimit penal. Me konstatimin e shkakut të pezullimit nis procedura për pezullimin nga detyra të ushtarakut.

b) Brenda 2 (dy) ditëve nga marrja dijeni mbi vendimin e gjykatës ose fillimin e procedimit penal, çdo strukturë, pjesë e të cilës është ushtaraku, i përcjellë propozimin për pezullimin nga detyra strukturës eprorë. Në çdo rast propozimi shoqërohet me një kopje të vendimit të gjykatës për masën e sigurisë (arrest me burg ose arrest shtëpie) ose njoftimin e Policisë Ushtarake mbi fillimin e procedimit penal të ushtarakut, për shkelje që kanë lidhje me detyrën.

c) Pezullimi i oficerëve të Forcave, strukturave mbështetëse:

- Brenda 2 (dy) ditëve nga marrja e propozimit nga komanda vartëse, struktura përgjegjëse e personelit në forcë ose strukturën mbështetëse, pasi verifikon bazën ligjore dhe dokumentacionin e nevojshëm, përgatit propozimin në emër të komandantit të Forcës/strukturës mbështetëse për shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së. Pas miratimit, propozimi i përcillet shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së.
- Brenda 2 (dy) ditëve nga marrja dijeni mbi propozimin e komandantit të Forcës ose strukturës mbështetëse, Drejtoria e Personelit në Shtabin e Përgjithshëm (J-1), përgatit propozimin në emër të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së për ministrin e Mbrojtjes. Pas miratimit nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, nëpërmjet Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, propozimi i paraqitet ministrit të Mbrojtjes.
- Struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore, brenda 2 (dy) ditëve nga marrja e propozimit të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, pasi verifikon dokumentacionin e nevojshëm, përgatit projekt-urdhrin e ministrit të Mbrojtjes për pezullimin nga detyra të ushtarakut/es.

ç) Për pezullimin e oficerëve të cilët janë pjesë e strukturave të SHPFA-së, ndiqet procedura e mëposhtme:

- Drejtoria e Personelit në SHPFA, brenda 2 (dy) ditëve nga marrja e njoftimit nga Policia Ushtarake ose me iniciativën e vet, për vendosjen e masës së sigurisë arrest me burg, arrest shtëpie ose fillimin e procedimit penal ndaj ushtarakut, përgatit propozimin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së për ministrin e Mbrojtjes për pezullimin e ushtarakut nga detyra. Pas miratimit nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, nëpërmjet Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, propozimi i paraqitet ministrit të Mbrojtjes.
- Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, brenda 2 (dy) ditëve nga marrja e propozimit përgatit projekt-urdhrin e ministrit të Mbrojtjes për pezullimin nga detyra të ushtarakut/es.

d) Për pezullimin e oficerëve të cilët janë pjesë e strukturave të varësisë së MM-së, ndiqet procedura e mëposhtme:

- Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, me marrjen dijeni të shkakut të pezullimit nga detyra të oficerit, brenda 2 (dy) ditëve, i paraqet ministrit të Mbrojtjes projekt-urdhrin për pezullimin nga detyra të ushtarakut.

dh) Për pezullimin e nënoficerëve dhe ushtarëve ndiqen procedurat e mëposhtme:

- Për nënoficerët dhe ushtarët, të cilët janë pjesë e strukturave të komandave të forcave ose komandave mbështetëse, struktura përgjegjëse e personelit, brenda 2 (dy) ditëve nga marrja dijeni për shkakun e pezullimit të nënoficerit ose ushtarit, pasi ka verifikuar bazën ligjore dhe dokumentacionin e nevojshëm, i paraqet për miratim komandantit të Forcës ose komandantit të strukturës Mbështetëse, projekt-urdhrin për pezullimin nga detyra të nënoficerit ose ushtarit.
- Për nënoficerët ose ushtarët, të cilët janë pjesë e strukturave të SHPFA-së ose MM-së ose e strukturave në varësi direkte të SHPFA-së ose MM-së, Drejtoria e Personelit në SHPFA, brenda 2 (dy) ditëve nga marrja dijeni për shkakun e pezullimit, pasi ka verifikuar bazën ligjore dhe dokumentacionin e nevojshëm, i paraqet shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së projekt-urdhrin për pezullimin nga detyra;

e) Pezullimi i shtrin efektet nga data e vendosjes së masës së sigurisë ose fillimit të procedimit penal deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë nga gjykata.

5.2 Procedurat kur pezullimi i referohet shkakut të përcaktuar në germën “c”, të pikës 2.

a) Ushtaraku që ndërmerr studime sipas pikës së mësipërme duhet të paraqesë në komandën eprorë, jo më vonë se 30 ditë nga fillimi i studimeve, kërkesën për ndjekjen e studimeve, duke specifikuar në të:

- llojin e studimit;
- periudhën e studimit/kohëzgjatjen e studimeve;
- institucionin arsimor përkatës dhe adresën e tij.;
- dokumentin e pranimit për ndjekjen e studimeve nga institucioni arsimor përkatës apo të fitimit të një të drejte studimi brenda apo jashtë vendit;
- arsyet e ndërmarrjes së studimeve.

b) Shkaku i pezullimit konstatohet nga struktura përgjegjëse e personelit në Komandën e Forcës, strukturën mbështetëse, strukturën e varësisë së SHPFA-së ose MM-së me marrjen e kërkesës së ushtarakut për ndjekjen e studimeve, me nismën e tij dhe në lidhje me funksionin që ai kryen, në përputhje me nenin 24, germa “b”, të ligjit nr. 59/2014.

c) Me konstatimin e shkakut të pezullimit, strukturat përgjegjëse të personelit në komandat e forcave, strukturat mbështetëse, SHPFA ose MM, nëpërmjet një memo miratuese, i paraqesin autoriteteve kompetente praktikën për miratimin paraprak ose jo të pezullimit

të ushtarakut. Nëpërmjet memos miratuese dhe dokumentacionit shoqërues, autoriteteve kompetente u argumentohet dhe sugjerohet miratimi ose mosmiratimi i kërkesës së ushtarakut.

- ç) Brenda 3 (tri) ditëve nga miratimi paraprak, struktura përgjegjëse e personelit në Komandën e Forcës, strukturën mbështetëse, SHPFA ose MM, i paraqet për miratim autoritetit kompetent projekt-urdhrit përkatës për pezullimin nga detyra të ushtarakut.
- d) Ushtaraku qëndron i pezulluar nga fillimi deri në mbarimin e studimeve.

5.3. Procedurat kur pezullimi i referohet shkakut të përcaktuar në germën “ç”, të pikës 2.

- a) Ushtaraku që kërkon të shoqërojë bashkëshortin ose bashkëshorten jashtë shtetit, për arsye të emërimit të tij në detyrë, duhet të paraqesë në komandën eprore kërkesën përkatëse, e cila shoqërohet edhe me një fotokopje të urdhrit të emërimit të bashkëshortit/es së tij/saj me detyrë jashtë vendit.
- b) Pezullimi konstatohet nga struktura përgjegjëse e personelit në Komandën e Forcës, strukturën mbështetëse, SHPFA ose MM, me marrjen e kërkesës së ushtarakut për të shoqëruar bashkëshortin ose bashkëshorten, që është emëruar jashtë shtetit në funksione zyrtare, me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, bazuar në nenin 24, germa “c”, të ligjit nr. 59/2014.
- c) Procedurat e tjera ndiqen sipas germave “c”, “ç” të pikës 5.2 të këtij udhëzimi.
- ç) Pezullimi mbaron me përfundimin e detyrës së ushtarakut/ushtarakes jashtë vendit, por nuk zgjat më shumë se 4 vite.

6. Trajtimi financiar i ushtarakut gjatë periudhës së pezullimit.

- a) Ushtaraku nuk paguhet gjatë periudhës së pezullimit, për shkaqet e përcaktuara në pikën 2, të Kreut II të këtij udhëzimi.
- b) Kur ushtaraku pezullohet nga detyra, sipas germës “ç”, të pikës 2, të Kreut II, trajtohet financiarisht sipas VKM nr. 854, datë 17.12.2004 “Për kriteret dhe masën e përfitimit të pagës së papunësisë për bashkëshortin/in e ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura, për aq kohë sa zgjat pezullimi.

7. Njohja e periudhës së pezullimit.

Periudha e kohës së pezullimit nga detyra njihet si vjetërsi grade dhe shërbimi në Forcat e Armatosura, kur pezullimi ndodh për rastin e parashikuar në germat “a” dhe “b”, të pikës 2, të Kreut II dhe çështja penale pushohet ose kur me vendim gjykate të formës së prerë ushtaraku deklarohet i pafajshëm, ndërsa për rastet e parashikuara në germat “c” dhe “ç”, të pikës 2, të Kreut II, periudha e pezullimit njihet vetëm për efekt të vjetërsisë së gradës.

KREU III PËRFUNDIMI I PEZULLIMIT

1. Përfundimi i pezullimit dhe procedura e rikthimit në detyrë.

Përfundimi i pezullimit konstatohet nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore.

1.1. Për rastin e parashikuar në germet “a” dhe “b”, të pikës 2, të Kreut II.

- a) Në rast dënimi me burg të ushtarakut/es zbatohet procedura e nxjerrjes në lirim.
- b) Në rast se çështja pezullohet dhe ushtaraku shpallet i pafajshëm përfundon shkaku i pezullimit dhe fillon procedura e rikthimit në detyrë/emërimit në detyrë. Procedura është e njëjtë me procedurën e zakonshme të emërimit në detyrë.
- c) Struktura që bën propozimin për emërimin në detyrë, për arsye se shkaku i pezullimit ka pushuar së ekzistuari, duhet të shoqërojë propozimin edhe me vendimin e gjykatës të formës së prerë.
- ç) Propozimi për emërim bëhet brenda 5 (pesë) ditëve nga sigurimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës.
- d) Në rast se pozicioni i punës është i lirë ushtaraku kthehet në atë pozicion, në të kundërt emërohet në një pozicion tjetër në përputhje me gradën që mban.
- dh) Komandat duhet të ndjekin në vijimësi çështjet gjyqësore dhe të sigurojnë në kohën e duhur vendimin e formës së prerë të gjykatës.

1.2. Për rastin e parashikuar në germën “c”, të pikës 2, të Kreut II.

- a) Me mbarimin e periudhës së studimeve të ndërmarra me nismën e vet bie edhe shkaku i pezullimit.
- b) Përfundimi i pezullimit konstatohet nga njësia e burimeve njerëzore (degët/seksionet e personelit) përkatëse mbi bazën e kërkesës së ushtarakut për përfundimin e studimeve të ndërmarra me nismën e tij.
- c) Me përfundimin e studimeve, ushtaraku brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e kthimit të studimeve, bën kërkesë për përfundimin e pezullimit dhe kthimin në detyrë. Kërkesa i adresohet komandës, pjesë e të cilës ushtaraku ka qenë në momentin e pezullimit dhe shoqërohet me dokumentacionin i cili vërteton përfundimin e studimeve (diplomën mbi përfundimin e studimeve përkatëse dhe biletën e udhëtimit).
- ç) Ushtaraku është i detyruar që ta shoqërojë kërkesën për përfundimin e pezullimit dhe kthimin në detyrë me informacionin e mëposhtëm: një informacion mbi studimet e kryera, kurrikulën, shtetin ku ka kryer studimet, universitetin përkatës, adresën e universitetit, adresën elektronike të tij, adresën e akomodimit në shtetin ku ka ndjekur studimet, titullin akademik të përfutur, në rast se ka përfunduar me sukses studimet.

- d) Brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e kërkesës, Komanda e Forcës, strukturat mbështetëse ose komanda e strukturës të varësisë të SHPFA-së/MM-së, ia përcjellin propozimin përkatës nëpërmjet Drejtorisë së Personelit në SHPFA, shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, për rastet të cilat janë kompetencë e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe ministrit të Mbrojtjes.
- dh) Kur dokumentacioni i paraqitur vërteton se ushtaraku ka qenë me studime sipas urdhrit të pezullimit, ai emërohet në detyrë, në të kundërt ndaj tij fillon procedura për ndjekje penale dhe nxjerrjen në lirim. Në rastet kur ushtaraku ndërpret studimet përpara afatit të përcaktuar, zbaton kërkesat e germës ç, të pikës 1.2, të Kreut III.
- e) Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, brenda 5 ditëve, nëpërmjet Drejtorisë së Personelit në SHPFA, ia përcjell propozimin ministrit të Mbrojtjes.
- ë) Brenda 3 (tri) ditëve nga marrja e propozimit të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, pasi ka verifikuar bazën ligjore dhe dokumentacionin e nevojshëm, përgatit një memo miratuese për ministrin e Mbrojtjes për përfundimin e pezullimit dhe miratimin paraprak ose jo të propozimit për emërimin në detyrë.
- f) Brenda 3 (tri) ditëve nga miratimi i propozimit nga ministri i Mbrojtjes, Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve përgatit projekt-urdrin për emërimin në detyrë të ushtarakut/es.
- g) Periudha e pezullimit në këtë rast njihet vetëm si vjetërsi në gradë.

KREU IV

STRUKTURAT PËRGJEGJËSE PËR ZBATIMIN E UDHËZIMIT

1. Përgjigjen për zbatimin e këtij udhëzimi Shtabi i Përgjithshëm i FA-së, komandantët e Forcave, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, komandanti i Komandës Mbështetëse, komandantët e njërive dhe reparteve të varësisë të drejtpërdrejtë të MM-së dhe SHPFA-së, Qendra e Personel-Rekrutimit, Drejtoria e Personelit në SHPFA, si dhe Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, në Ministrinë e Mbrojtjes.
2. Ndjek zbatimin e këtij udhëzimi sekretari i përgjithshëm dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

